

## KONTAKTE

---

Telephone: +355 33 222288

### PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI

Prof. As. Dr. Armela Panajoti

Email: [armela.panajoti@univlora.edu.al](mailto:armela.panajoti@univlora.edu.al)

---

### KOORDINATOR PËR MARRËDHENIET ME STUDENTËT

Dr. Ilda Kanani

Email: [ilda.kanani@univlora.edu.al](mailto:ilda.kanani@univlora.edu.al)

---

### SEKRETARE E DEPARTAMENTIT

Arbana Kokoshi

Email: [kokoshiarbana@gmail.com](mailto:kokoshiarbana@gmail.com)

---

Website:

<https://univlora.edu.al/fshh-departamenti-i-gjuheve-te-huaja/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/dgjh.fshh.univlora.edu.al/>

---



### Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Shkencave Humane  
Godina B

Rr. Sulejman Delvina 9400  
Vlore, Shqipëri

---

## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

---

### *Viti akademik 2019-2020*



Oferta akademike e Departamentit të  
Gjuhëve të Huaja për vitin akademik  
2019-2020:

#### *Programe Bachelor:*

*Bachelor* në gjuhë angleze

*Bachelor* në gjuhë italiane

#### *Programe Master:*

*Master* profesional në mësimdhënie në  
gjuhë angleze

*Master* profesional në mësimdhënie në  
gjuhë italiane

*Master* i shkencave në përkthim dhe  
interpretim

# ÇFARË OFROJNË KETO PROGRAMET? KUSH MUND TE APLIKOJE?

Departamenti i Gjuhëve të Huaja ofron dy diploma të ciklit të parë të studimeve *Bachelor*, në gjuhën angleze dhe gjuhën italiane, si dhe dy diploma të ciklit të dytë të studimeve, MP (*Master* profesional), në mësuesi në gjuhën angleze dhe gjuhën italiane dhe MSH (*Master* i shkencave në përkthim-interpretim).

1. Aplikimi për të fituar të drejtën e studimeve universitare bëhet sipas kriterëve të përgjithshme të bazuara në kriteret e shpallura me VKM dhe kriterëve specifike të shpallura nga çdo departamenti.

2. Pranimi për vitin akademik 2019-2020 do të bëhet mbi bazën e kriterit të mëposhtëm:

- Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore ka 100% të vlerësimit në renditje.

## PROGRAMET E STUDIMIT BACHELOR

Programet e studimit *Bachelor* në gjuhë angleze dhe *Bachelor* në gjuhën italiane synojnë të formojnë kryesisht specialistë të gjuhës së huaj me qëllim rritjen e standardeve në ofrimin e shërbimeve në administratën publike (shkolla tetëvjeçare) dhe profesionet e lira.

Ky program mësimor synon formimin e studentëve si specialistë të gjuhës së huaj, anglisht dhe italisht, në shkolla për nivelin parashkollor (neni 83/1, a në ligjin nr. 80/2015), në sektorin privat, në grupet e interesit, organizatat jo fitimprurëse në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, specialistë në shërbimet sociale, po edhe në marrëdhëniet tregtare etj.

## PROGRAMET E STUDIMIT “MASTER”

a) Programet e studimeve *Master* në mësuesi në gjuhën angleze dhe gjuhën italiane u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë universitare, së paku *Bachelor*, arsim dhe trajnim të mirëfilltë profesional.

b) Realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

c) Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet një diplomë universitare *Master* në fushën e arsimit të kryer.

d) Formojnë mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë.

## PROGRAMI I STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE”

a) Pajis të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare *Bachelor* me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e përkthimit.

b) Realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

c) Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare *Master i shkencave* në përkthim dhe interpretim.

## MUNDESI TË TJERA

- Studentët që studiojnë në departamentin tonë mund të përfitojnë nga të drejta studimi nga një semestër deri në një vit akademik në universitete partnere të huaja në kuadër të programit ERASMUS +. Për më shumë, ndiqni thirrjet që publikohen herë pas here në faqen e departmentit, <https://www.facebook.com/dgjh.fshh.univlora.edu.al/>.

- Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në shkolla verore që organizohen në bashkëpunim me universitete perëndimore dhe nga rajoni.

- Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete që kanë në fokus vetë ata si konferenca, seminare, konkurse etj.